REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA SARANDË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 6 Prot

# KONTRATË SIPËRMARRJE

## OBJEKTI

*"Rikonceptim dhe rivitalizim i qendres se qytetit Sarande, Rruga e Flamurit"*

SARANDË

2016



Scanned with CamScanner

## KONTRATË SIPËRMARRJE

Lidhur sot më datë **30.06.2016,** në bazë të nenit 419-658 dhe 850 -876 të Kodit Civil, te Ligjit Nr. 139/2015 "Per Veteqeverisien Vendore", **Vendimit të Keshillit Bashkiak Nr.6, date 05/03/2016 "Mbi miratimin e buxhetit per vitin 2016",** midis Bashkisë Sarandë, e përfaqësuar nga **Znj.Florjana KOKA** përfaqësues i vetëm në rolin e investitorit që më poshtë do të quhet **"Autoriteti Kontraktor"**
Dhe

Shoqerise **"ED KONSTRUKSION" SH.P.K.** me liçensë të shoqërisë **Nz. 4981/8, dhe vlefshmëri (Pa afat kohor),** lëshuar nga Ministria e Puneve Publike dhe Transportit, me **Nr. (NIPT) K 61625001 I,** nga Administratori i saj **Z.Alfred IBRAHIMI, dhe** Shoqërisë **"FUSHA"SH.P.K** me licencë të shoqërisë **NZ. 1163/15,** , me vlefshmëri pa afat kohor, lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, me **Nr. Nipti J 61922018 S** , nga Administratori i saj **Znj. Shkelqim FUSHA** të mëposhtë quajtur **"Kontraktuesi".**
Midis shoqërive **"ED KONSTRUKSION" SH.P.K,** dhe shoqërisë **"FUSHA" SH.P.K** është lidhur një kontratë bashkëpunimi **nr. 2714 Rep, nr.581 Kol, datë 21.05.2016**. Nëpërmjet kësaj kontrate, palët bien dakort për bashkëpunim të përkohshëm të shoqerive me rastin e pjesëmarrjes në të gjitha fazat e kualifikimit në tenderin me objekt: ***"Rikonceptim dhe rivitalizim i qendres se qytetit Sarande, Rruga e Flamurit"*** . Gjithashtu shoqëria **"FUSHA"SH.P.K.** ka lëshuar një prokurë të posacme **nr.2715 Rep, nr.582 Kol, date 21.05.2016**, me anë të së cilës autorizon Shoqërinë **"ED KONSTRUKSION" SH.P.K.** për ta përfaqësuar direkt në tender dhe të kryejë cdo veprim të nevojshëm dhe të ligjshëm lidhur me zbatimin e kontratës, duke nënshkruar të gjitha aktet juridike dhe dokumentat e tjera për tenderin.

### *Neni.1. Objekti i Kontratës*

**Objekti i kësaj kontrate është sipërmarrja me objekt:** ***"Rikonceptim dhe rivitalizim i qendres se qytetit Sarande, Rruga e Flamurit"***

### *Neni 2. Vlera e Kontratës*

Kontrata lidhet me një vlerë totale **102 518 468 (njëqind e dy milion e peseqind e tetemedhjete mije e katërqind e gjashtedhjete e tete)** lekë me T.V.SH. Financimi i objektit bëhet me fonde nga : FZHR.

### *Neni 3. Afati i Kontratës*

Afati maksimal i përfundimit të punimeve është **130 (dite)** nga dita e lidhjes së kontratës, por per arsye te sezonit turistik **fillimi i punimeve do te jete data 20.10.2016.**



Scanned with CamScanner

Drejtuar: BAS...

**Neni 4. Gjuha e Kontratës**

Gjuha në të cilën përpilohet kontrata është Gjuha Shqipe.

**Neni 5. Përkufizime**

***formulari i ofertës*** - është dokumenti i plotësuar që sipërmarrësi ka dorëzuar në datën e hapjes së tenderit dhe është pranuar nga Enti Prokurues.

***Vlera e kontratës*** është vlera e dhënë në njoftimin e fituesit që Enti Prokurues i ka dërguar Sipërmarrësit fitues mbi bazën e të cilës është plotësuar e dorëzuar formulari i kontratës, nga ky i fundit.

***Data e përfundimit të kontratës*** është data e vërtetuar nga Enti Prokurues.

***Sipërmarrësi*** është një person juridik ose fizik i pranuar nga Enti Prokurues.

***Ditët*** janë ditë kalendarike dhe ***muajt*** janë muaj kalendarik.

***Data e fillimit*** është data e lidhjes së kontratës.

***Ndryshimi*** është një udhëzim që jep Investitori i paparashikuar në dokumentat fillestare dhe jepet gjithmonë me shkrim.

***Preventiv*** janë vëllimet e punës të plotësuara me çmime, pjesë përbërëse e ofertës.

***Raste të kompensuara*** janë ato që përcaktohen në pikën 25.

***Difekte*** është çdo pjesë e punimeve të parealizuara në përputhje me kontratën.

***Periudha e garancisë*** së difekteve është 12 muaj.

***Skica*** (vizatimet ) përfshijnë projektet dhe të dhëna të tjera të paraqitura ose të miratuara nga Enti Prokurues për përmbushjen e Kontratës.

***Investitori*** është organi qëndror ose lokal që vë në dispozicion fondin.
**Autoriteti Kontraktor** është organi qëndror ose lokal që realizon prokurimin e objektit.

Scanned with CamScanner

***Mbikëqyrësi i Punimeve*** është personi kompetent i emëruar nga Investitori dhe që i është njoftuar Sipërmarrësit, i cili është përgjegjës për mbikqyrjen e realizimit të punimeve dhe administrimin e kontratës.

***Drejtori Teknik i Punimeve*** në objekt është personi i aprovuar nga Enti Prokurues, përfaqsues i Sipërmarrësit, përgjegjës për kryerjen dhe përfundimin e punimeve, për të cilin Sipërmarrësi është i detyruar t'i konfirmojë Investitorit emrin e tij.

***Paisjet*** janë makineritë e Sipërmarrësit të sjella përkohësisht në kantierin ku do te kryhen punimet.

***Materialet*** janë furnizimet që përfshijnë edhe ato të konsumit të përdorura nga Sipërmarrësi për kryerjen e punimeve, në përputhje me standartet e RSH.

***Specifikimet*** janë karakteristikat e punimeve të përfshira në projektet e zbatimit në dokumentat standarte të tenderit dhe çdo modifikim ose shtesë e bërë dhe e miratuar me shkrim nga Investitori.

***Dokumentat e tenderit*** janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

***Punimet*** janë punimet që duhet të kryhen nga Sipërmarrësi në përputhje me kontratën, projektin dhe ndryshimet e tij.

***Neni 6. Komunikimi***

6.1 Komunikimi midis palëve duhet të bëhet vetëm me shkrim në adresat e deklaruara nga palët, në rast se ka ndryshim të adresës palët janë të detyruara të informojnë për çdo ndryshim. Njoftimi bëhet efektiv vetëm pasi të dorëzohet.

***Neni 7. Prona Intelektuale***

7.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Sipërmarrësi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Investitorit i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

7.2 Me përjashtim të rasteve kur palët bien dakort ndryshe, Sipërmarrësi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i paraqesë Investitorit të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Sipërmarrësi gjatë zbatimit të kontratës. Sipërmarrësi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Enti Prokurues.

Scanned with CamScanner

7.3 Sipërmarrësi duhet të sigurojë Investitorin nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

7.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Investitiorit në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur të furnizuar sipas kontratës, Sipërmarrësi duhet t'i japë Investitorit të gjitha provat dhe informacionin në posedim të tij që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

***Neni 8. Mbikqyrësi i Punimeve***

8.1 Mbikqyrës i punimeve do të jetë ***Shoqeria "HP STUDIO" SH.P.K*** Licence profesionale të shoqërisë lëshuar nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Komisioni i Dhënies së Liçensave Profesionale pranë M.RR.T.T me date 07.04.2015 dhe me Nr.MK.2529/1 .

8.2 Detyrat e mbikqyrësve të punimeve burojnë nga aktet ligjore dhe n/ligjore në fuqi dhe detajohen në kontratën e shërbimit që do të lidhet me këta të fundit.

8.3 Në rast se mbikqyrësi do të ndryshohet, investitori njofton menjëherë Sipërmarrësin.

***Neni 9. Personeli i Sipërmarrësit***

9.1 Sipërmarësi do të punësojë vetëm personelin e deklaruar në ofertë për kryerjen e funksioneve të parashikuara në programin e miratuar nga Mbikqyrësi i Punimeve. Mbikqyrësi i Punimeve do ti propozojë Investitorit për të zëvendësuar personelin kryesor vetëm nëqoftëse kualifikimet dhe aftësitë e tyre të nevojshme janë baraz ose më të larta se ato të personelit të përcaktuar në ofertën e Sipërmarrësit.

9.2 Në qoftë se Mbikqyrësi i Punimeve i kërkon Sipërmarrësit që të largojë një person, i cili është anëtar i personelit ose i fuqisë punëtore të Sipërmarrësit, duke theksuar arsyet, Sipërmarësi do të marrë masa për të siguruar që personi në fjalë të largohet nga kantieri i punimeve brenda 72 orëve dhe të mos ketë më lidhje me punën e përfshirë në kontratë.

9.3 Drejtori Teknik i Punimeve të objektit është **Vullnet Sejdini dhe Pandeli Berberi** me liçencë **NZ. 4981/8,** lëshuar nga Komisioni i Dhënies së Liçensave pranë M.RR.T.T. Detyrat e Drejtorit Teknik të Punimeve janë si më poshtë:

Scanned with CamScanner

- Zbatimin e objektit konform projektit dhe kushteve teknike të zbatimit
- Dokumentacionin teknik që është i detyrueshëm të mbahet në objekt;
- Korrespondencën zyrtare me Mbikqyrësin e Punimeve;
- Ecurinë e zbatimit të punimeve konform plan organizimit dhe grafikut të punimeve;
- Është i pranishëm në të gjitha fazat e realizimit të objektit: zbatimin e punimeve, dorëzimin dhe kolaudimin e objektit.

9.4 Në rast se ndryshohet Drejtori Teknik, Sipërmarrësi duhet detyrimisht të lajmërojë Mbikqyrësin e Punimeve i cili vë në dijeni Investitorin.

***Neni 10. Detyrimet e Sipërmarrësit***

10.1 Sipërmarrësi do të kryejë punimet në përputhje me projektet e ndryshimet e miratuara dhëna nga Investitori dhe në përputhje me K.T. të zbatimit të RSH.

10.2 Drejtori Teknik i Punimeve në kantier, është i detyruar të mbajë ditarin e objektit, ku të përfshihen të gjitha punimet e kryera dhe urdhërat e dhëna për zbatimin e projektit. Ky ditar në çdo kohë do ti vihet në dispozicion Mbikqyrësit të punimeve, grupit të kolaudimit dhe Investitorit.

10.3 Sipërmarrësi do të kryejë punime me nënsipërmarrje pasi të ketë marrë miratimin e Investitorit. Marrëdheniet e n/sipërmarrjes do rregullohen nëpërmjet një marrëveshjeje e cila përcakton qartë nënsipërmarrjen dhe që në çdo rast është e detyruar të respektojë të gjitha detyrimet e kontrates së sipërmarrjes. Përgjegjës ndaj Investitorit mbetet gjithmone Sipërmarrësi kryesor i punimeve.

10.4 Sipërmarrësi ka për detyrë të ruaj projektin dhe të mos e përdorë atë në objekte të tjera jashtë këtij tenderi. Gjithashtu të mos japë asnjë informacion (botim artikujsh apo fotografish) mbi ecurinë e punimeve pa lejen e Investitorit.

10.5 Sipërmarrësi është i detyruar të marri të gjitha masat për kufizimin e ndotjes së ambjentit duke përdoruar të gjitha mjetet në dispozicion.

10.6 Sipërmarrësi është i detyruar të përdori mjetet e sinjalistikës rrugore për punime në rrugë me qëllim disiplinimin e trafikut të mjeteve dhe kalimtarëve në objektin e ndërtimit.

10.7 Sipërmarrësi është i detyruar të paisë punonjësit e tij në objekt me uniforma në të cilat të jenë shprehur shenjat dalluese të shoqërisë Sipërmarrëse.

10.8 Në rast të mos respektimit të dispozitave të parashikuara në pikat 10.5 - 10.7 të mësipërme Mbikqytësi i punimeve i bën njoftim Sipërmarrësit për

Scanned with CamScanner

respektimin e detyrimeve të shprehura më lart. Në rast se Sipërmarrësi nuk merr masa brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit atëherë Mbikqyrësi i punimeve i propozon Investitorit aplikimin e një penaliteti në masën nga 50.000 lekë deri 200.000 lekë, penalitet i cili do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqiten për likujdim.

***Neni 11. Testimet dhe Inspektimet***

**11.1** Sipërmarrësi është i detyruar që me shpenzimet e veta të kryejë provat laboratorike të materialeve që do të përdoren në objekt si dhe provat e kampioneve të marra nga objekti në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Mbikqyrësi i Punimeve.

11.2 Sipërmarrësi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Sipërmarrësi brenda kushteve të çmimit të kontratës

11.3 Investitori gjithashtu mund t'i kërkojë Sipërmarrësit të bëjë testime ose inspektime shtesë të pa parashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se ndërtimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës.

11.4 Investitori do të refuzojë çdo punim ndertimi që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

11.5 As egzekutimi i testeve as inspektimi i punimeve te ndertimit nuk do ta lirojë Sipërmarrësin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

***Neni 12. Ngritja e Kantierit***

12.1 Sipërmarrësi do të mbajë përgjegjësi për skicimin e Ngritjes se Kantierit.

12.2 Sipërmarrësi duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek Mbikqyrësi i Punimeve për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

***Neni 13. Zbulimet***

13.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të bëhet pronë e Investirorit. Sipërmarrësi duhet të njoftojë Mbikqyrësin e Punimeve për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhezimet e drejtuesit të projektit për procedurën e ndjekjes me objektet.

Scanned with CamScanner

## *Neni 14. Sigurimi Teknik*

14.1 Sipërmarrësi është përgjegjës për të gjithë veprimtarinë në kantierin e ndërtimit, duke zbatuar masat korigjuese dhe rregullat e sigurimit teknik për gjithë personelin sikurse përcoktohet në legjislacionin Shqiptar.

## *Neni 15. Rreziqet e Sipërmarrësit dhe Forca Madhore*

15.1 Sipërmarrësi ka për detyrë të përballojë të gjitha shpenzimet që mund të dalin nga data e fillimit të punimeve e deri në fund të periudhës së garancisë për difektet që mund të shfaqen në objekt sipas të dhënave të kontratës. Sipërmarrësi deri në përfundim të punimeve do të përballojë rreziqet për shkak të dëmtimeve të personelit, vdekjes dhe humbjes ose dëmtimit të pasurisë (përfshirë pa kufizime punimet, materialet dhe paisjet, kantierin e ndërtimit si dhe objektin e ndërtimit).

15.2 Sipërmarrësi nuk do të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit te kontratës jo për fajin e tij, dëmeve të likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim në se dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

15.3 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Sipërmarrësit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Investitorit qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

15.4 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Sipërmarrësi duhet të njoftojë menjehere Invetitorin. Me përjashtim kur Investitori jep direktiva të ndryshme, Sipërmarrësi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin e kontrtatës deri në masën e mos pengesës nga Forca Madhore.

## *Neni 16. Sigurimet*

16.1 Sipërmarrësi duhet të sigurojë objektin me vlerë totale: 10 251 847 **(dhjete milion e dyqind e pesedhjete e nje mije e tetëqind e dyzete e shtate )** leke me emra të përbashkët të Investitorit dhe Sipërmarrësit, nga data e hyrjes ne kantier deri në datën e realizimit së plote te ndertimeve, për humbje ose dëmtim të Ndertimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

16.2 Rregulloret për çertifikatat e siguracionit do ti dorëzohen Mbikqyrësit të Punimeve për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. I gjithe ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Në se Sipërmarrësi dështon të sigurojë certifikatat e

Scanned with CamScanner

kërkuara të siguracionit, kontrata do të konsiderohet e anulluar. Megjithatë, Investitori ka të drejtë të vendosi të zgjasë periudhën e paraqitjes të çertifikatave të siguracionit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep Sipërmarrësit.

16.3 Ndryshime në afatet e siguracionit nuk duhet të bëhen pa aprovimin me shkrim të Investitorit.

*Neni 17. Preventivi*

17.1 Preventivi do të përfshijë të gjitha zërat e punimeve me çmimet përkatëse të parashikuara në ofertë .

17.2 Preventivi do të përdoret për të llogaritur vlerën e kontratës. Sipërmarrësi paguhet me sasinë e punës së kryer sipas projektit, bazuar për çdo zë pune të preventivit.

17.3 Për zërat e reja, të paparashikuara në preventiv përveç dokumentacionit përkatës paraqitet edhe analiza teknike për çdo zë të ri pune.

17.4 Nën/zërat e punimeve për të cilat nuk është vënë çmim për njësi në ofertën e paraqitur, do të konsiderohen si të mbuluara nga vlerat e tjera të përfshira në kontratë.

*Neni 18. Negociatat dhe Amendamentet*

18.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshontë mjaftueshëm kushtet që kanë përbërë bazën e përzgjedhjes së Sipërmarrësit.

18.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë dhe duke u referuar shprehimisht kontratës. Çdo shtesë ose ndryshim Amendamenti do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se nënshkruhet nga të dyja palët ose nga persona të autorizuar prej tyre.

18.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, në të cilën të specifikohet data dhe të nënshkruhen nga pala ose nga një përfaqsues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

*Neni 19. Ndryshimi i Porosisë*

Scanned with CamScanner

19.1 Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegocimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe e nënshkruar nga Investitori dhe Sipërmarrësi

19.2 Investitori mund që në çdo kohë mund të porosisë Sipërmarrësin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin prej e sa më poshtë:

- Korrigjime në skicimin, vizatimin ose specifikimet e Ndertimeve;
- Korrigjime në materiale;
- Korrigjime në sasi.

19.3 Përpara se të kërkojë një ndryshim, Investitori dhe Sipërmarrësi duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në skedimin e dorëzimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të trupëzojë amendamentet e marrveshjes. Investitori nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.

19.4 Ndryshimi i porosise nuk do te jete i vlefshem ne se nuk formalizohet sipas kerkesave te Nenit 18 te kesaj kontrate.

19.5 Çdo ndryshim i urdhëruar nga Investitori, do të jetë detyrimisht objekt i një proçes - verbali (urdhëri) me shkrim i firmosur nga Investitori. Këto urdhëra do të hartohen në bazë të një propozimi teknik nga ana e Investitorit dhe në baze të llogarive përkatëse të bëra nga Sipërmarrësi dhe Mbikqyrësi i Punimeve, mbështetur në çmimin njësi për çdo zë pune shprehur në preventiv.

19.6 Çdo ndryshim i cili sjell rritjen e vlerës së kontratës duhet të dokumentohet gjatë zbatimit të punimeve dhe pasi pregatitet dokumentacioni përkatës si preventivi shtesë, vizatime etj., i propozohen zyrtarisht entit që delegon fondin që të miratojë shtesën e vlerës së plotë si dhe për të gjetur burimet e financimit

Nëse volumet përfundimtare të punimeve të kryera, ndyshojnë nga volumet në Preventiv dhe vlera e tyre është brenda preventivit të objektit dhe fondit rezervë të parashikuar në preventiv, Investitori ngarkon Mbikqyrësin për të sistemuar volumet dhe për të dokumentuar ndryshimet e mundëshme dhe mandej i miraton ato .

***Neni 20. Programi***

Brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës Sipërmarrësi do ti paraqes për miratim Mbikqyrësit të Punimeve një program, në të cilin tregohet mënyra e kryerjes së

Scanned with CamScanner

punimeve dhe grafiku kohor. Sipërmarrësi do të realizojë programin sipas grafikut të parashikuar.

Sipërmarrësi ka të drejtë t'i propozojë Mbikqyrësit të punimeve ndryshime në grafikun e punimeve duke i motivuar ato.

Në rast se mund ose lind nevoja e dorëzimit të pjesshëm të punimeve këto parashikohen në grafikun e punimeve ose në ndryshimet e propozuara dhe të miratuara nga investitori.

### *Neni 21. Korrigjimi i Difekteve*

Sa herë që gjatë periudhës së zhvillimit të punimeve, nga Mbikqyrësi konstatohet një difekt Sipërmarrësi është i detyruar ta korigjojë atë brënda afatit që i lihet me shkrim por jomë vonë se 15 ditë.

Gjatë periudhës së garancisë së punimeve Mbikqyrësi i punimeve do të njoftojë Sipërmarrësin lidhur me çdo difekt para mbarimit të kësaj periudhe. Për eliminimin e difekteve lihet një afat i cili saktësohet sipas çdo rasti konkret por jo më shumë se 15 ditë.

Periudha e garancisë për difektet është afati 12 muaj duke filluar nga data e aktit te kolaudimit te punimeve.Me përfundimin e kësaj periudhe Sipërmarrësi paraqit kërkesën e kthimit të vlerës së garancisë së punimeve e cila i është mbajtur nga Investitori. Ky i fundit, brenda 10 ditëve organizon vizitën në terren ku kontrollohen realizimet e detyrave të lëna nga korigjimi i difekteve të lindura gjatë periudhës së garancisë së punimeve. Në se janë kryer gjithë korigjimet e difekteve atëhere hartohet akti përkatës i marrjes në dorëzim të objektit dhe që shënon përfundimin e detyrimeve reciproke të kontratës së sipërmarrjes dhe asaj të mbikqyrjes së punimeve.

### *Neni 22. Difektet e Pakorrigjuara*

Në qoftëse Sipërmarrësi nuk korigjon difektet e konstatuara në periudhën e garancisë së difekteve, brenda afatit të përcaktuar , Investitori do të vlerësojë koston e korigjimit të difektit, dhe Sipërmarrësi do të paguaj këtë shumë, së bashku me një gjobë të veçantë e cila do të jetë 0.04% të vlerës së kontraktuar për çdo ditë vonesë. Investitori do ta mbajë këtë shumë duke e zbritur nga garancia e punimeve e cila është mbajtur progresivisht në situacione .

Në se me përfundimin e periudhës së garancisë Sipërmarrësi nuk ka korigjuar difektet e konstatuara Investitori i zbret nga garancia deri ne konfiskimin e krejt garancisë së punimeve.

Scanned with CamScanner

**Neni 23. Situacionet**

Sipërmarrësi do t'i paraqesë Mbikqyrësit të Punimeve brenda 5 ditëve të para të çdo muaji situacionet mujore progresive për punimet e kryera, duke zbritur pagesat e situacioneve të mëparëshme, garancinë e difekteve, paradhënien etj., të kësaj natyre, sikurse përcaktohet në këtë kontratë.

Mbikqyrësi i Punimeve do të kontrollojë punën e kryer nga Sipërmarrësi dhe do të vërtetojë shumën që duhet ti paguhet Sipërmarrësit brenda 10 ditëve nga paraqitja e situacionit. Gjatë kontrollit Mbikqyrësi përcakton vlerën e punimeve të kryera.

Vlera e punës së kryer do të përfshijë vlerën e volumeve të zërave të punimeve të përfunduara dhe të shprehura në preventiv, vlerën e ndryshimeve dhe të rasteve të kompensuara pa prekur fondin rezervë i cili do financohet në situacionin përfundimtar në se ka dokumenta që argumentojnë përdorimin e tij.

**Neni 24. Pagesat**

Pagesat për çdo situacion punimesh do të kryhen nga investitori brenda 15 ditëve nga dita e firmosjes së situacionit nga Mbikqyrësi i Punimeve.

Pagesa e situacioneve do të kryhet sipas financimit të parashikuar në pikën 2 të kësaj kontrate.

**Neni 25. Rastet e Kompesuara**

Rastet e kompensuara për të cilat vonesa justifikohet do të konsiderohen si vijojnë:

a) Mbikqyrësi i Punimeve urdhëron shtyrjen ose nuk jep skicat (vizatimet) specifikimet ose udhëzimet e nevojshme për kryerjen e punimeve në kohën e caktuar.
b) Mbikqyrësi i Punimeve udhëzon Sipërmarrësin për të zbuluar punimet e fshehta ose për të kryer provat pas kryerjes së punimeve.
c) Autoritet Publike ose Investitori shkaktojnë vonesa në lirimin e sheshit të ndërtimit për Sipërmarrësin.
d) Investitori vonon pa arsye lëshimin e çertifikatës së marrjes në dorëzim.

Kompensimi i rasteve të sipërpërmendura do të bëhet si vijon:

Scanned with CamScanner

Për vonesat e përmendura në pikat 25.1 (a,b,c,d) Investitori do të njohë shtyrjen e datës së përfundimit të punimeve mbi atë të parashikuar në këtë kontratë.

***Neni 26. Taksat***

26.1 Sipërmarrësi është i detyruar të paguajë të gjitha taksat në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

Për taksat e përcaktuara në legjislacionin që ka hyrë në fuqi 28 ditë para datës së hapjes së tenderit, të cilat Sipërmarrësi duhet ti ketë marrë parasysh në vlerën e kontratës, Investitori nuk do ti njohë asnjë shtesë pagese.

***Neni 27. Dëmshpërblimi për Vonesat***

Sipërmarrësi do ti paguaj Investitorit dëmshpërblimin për vonesa në afatin e përfundimit të punimeve në masën 4/1000 te vleres korispoduese te mbetur pa u zbatuar nga çmimi total të kontratës.
Por kjo vlere do te llogaritet minimalishte mbi 25% te vleres se kontrates.

.

***Neni 28. Garancia e Difekteve***

Garancia e difekteve do të jetë 5% e vlerës se kontratës që do ti mbahet nga çdo situacion Sipërmarrësit si garanci për cilësinë e punimeve, shumë e cila do të paguhet mbas përfundimit të periudhës së garancisë së punimeve, duke marrë parasysh edhe saksionet e parashikuara në pikën 22 të kësaj kontrate.

***Neni 29. Kostoja e Riparimeve***

Dëmtimi i punimeve ose humbja e materialeve që do të përdoren për punimet nga dita e fillimit deri në marrjen në dorëzim si dhe gjatë afatit të garancisë së difekteve do të mbulohet nga Sipërmarrësi me shpenzimet e tij nëqoftëse humbja ose dëmtimi janë shkaktuar nga gabimet e veprimeve të tij.
Riparimet që dalin të nevojshme gjatë kolaudimit të veprës, nëse janë për shkak të mosplotësimit të kontratës ose të punës jo cilësore të Sipërmarrësit do të mbulohen nga ky i fundit me shpenzimet e tij.

***Neni 30. Marrja në Dorëzim e Punimeve***

Sipërmarrësi pas përfundimit të Punimeve njofton me shkrim Mbikqyrësin e Punimeve dhe Investitorin. Në se Mbikqyrësi nukka vrejtje ky njoftim shënon datën e përfundimit të punimeve. Sipërmarrësi pas njoftimit të përfundimit të punimeve i paraqet brënda 30 ditëve Mbikqyrësit të Punimeve dokumentacionin dhe llogaritjet përfundimtare për punimet e kryera.

Scanned with CamScanner

Mbikqyrësi i Punimeve mbas verifikimeve brenda 30 ditëve së bashku me relacionin e tij i'a paraqet gjithë dokumentacionin Investitorit.
Mbas marrjes së gjithë dokumentacionit Investitori i paraqet komisionit të kolaudimit gjithë dokumentacionin e realizimit të objektit. Me pëfundimin e procedurave të kolaudimit Investitori lëshon çertifikatën e marrjes në doërëzim të punimeve të kryera dhe do të çlirojë garancinë e sigurimit të Kontratës. Nga data e akt-kolaudimit të punimeve fillon periudha e garancisë së punimeve.
Në fund të periudhës së garancisë së punimeve, Mbikqyrësi i Punimeve dhe komisioni i marrjes në dorëzim të objektit do të përpilojnë së bashku me Investitorin aktin e marrjes në dorëzim të veprës, objekt i kësaj kontrate.

***Neni 31. Zgjidhja e Kontratës***

Investitori ose Sipërmarrësi mund të pezullojë kontratën kur vëren shkelje themelore të saj.

Shkeljet themelore të kontratës përfshijnë por nuk kufizohen në sa vijon:

a) Sipërmarrësi nuk fillon punë brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës si dhe në rastet kur ndalohen punimet me shumë së 10 ditë kur nuk parashikohet në programin e punës dhe ndalimi i punimeve nuk është i autorizuar nga Mbikqyrësi i Punimeve dhe nuk respektohet grafiku i punimeve.

b) Mbikqyrësi i Punimeve udhëzon pezullimin e punimeve duke njoftuar Investitorin dhe Sipërmarrësin.

c) Sipërmarrësi falimenton ose fillon likujdimin për arsye të tjera përveç rindërtimit ose bashkimit të shoqërisë.

e) Sipërmarrësi vonon kryerjen e punimeve dhe nuk realizon korrigjimet e difekteve të propozuara nga Mbikqyrësi i Punimeve.

***Neni 32. Pagesa pas Zgjidhjes së Kontratës***

Në rast se kontrata prishet nga Investitori për arsye objektive, Mbikqyrësi i Punimeve do të lëshoje një çertifikatë për vlerën e punës së kryer duke zbritur pagesat e marra deri në ditën e lëshimit te çertifikatës.

***Neni 33. Pasuria***

Të gjitha punimet e kryera dhe materialet e montuara për realizimin e objektit do të konsiderohen si pronë e Investitorit në rast prishje kontrate.

***Neni 34. Zgjidhja e Mosmarrveshjeve***

Scanned with CamScanner

Investitori dhe Sipërmarrësi do të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që do t'u lindë gjatë realizimit të kësaj kontratë.
Në rast se palët nuk bien dakort atëhere për sqarimin e mosmarrëveshjeve ngrihet një grup i përbërë nga tre ekspertë ku secila palë ka paraqitur një ekspert kurse i treti pranohet nga të dy palët. Në rast se problemi nuk zgjidhet nga grupi i ekspertëve atëhere palët do t'i drejtohen Gjykatës Tiranë.

***Neni 35 Fotografimet***

35.1 Sipermaresi do te kryej fotografimet ne kantier dhe ti **hedhe ne CD**, para dhe pas perfundimit te Punimeve te ndertimeve.
35.2 Fotografite do ti vihen ne dispozicion investitorit ne momentin e maries ne dorezim te objketit.

***Neni 36. Legjislacioni Bazë***

Ligji i aplikueshëm do të jetë Legjislacioni Shqiptar.

***Neni 37. Garancia e Kontratës***

Garancia e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Kjo garanci ngurtësohet nga Sipërmarrësi për llogari të Investitorit para nënshkrimit të Kontratës. Zhbllokimi i kontrates prej 10% do te behet pasi te jete perfunduar plotesisht kolaudimi i punimeve .

***Neni 38. Dispozita të Fundit***

37.1 Kjo kontratë do te quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga të dy palët. Kjo kontratë u hartua në 5 (pesë) kopje, tre nga të cilat i mban Investitori dhe dy kopje i mban Sipërmarrësi.

Konc.Dakt.E.Gjoni

| AUTORITETI KONTRAKTOR | SIPËRMARRËSI |
|---|---|
| BASHKIA SARANDË | "FUSHA"&"ED KONSTRUKSION"SH.P.K |
| KRYETARE | PERFAQESUESI ME PROKURE |
| FLORJANA KOKA | Z.ALFRED IBRAHIMI |

Scanned with CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË

# VENDIM

**Nr. 6/1 Datë 30.06.2016**

Në zbatim të Ligjit nr. 7971, datë 26.07.1995 "Për prokurimin publik", të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 si dhe udhëzimit nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për Drejtimin dhe Kolaudimin e punimeve të ndërtimit",

**V E N D O S A**

Të caktoj **shoqerine "HP STUDIO" Sh.p.k me administrator Z.Ilirjan Proko,** si mbikqyres punimesh për objektin: ***"Rikonceptim dhe rivitalizim i qendres se qytetit Sarande, Rruga e Flamurit"***.

**Konc.Dakt.E.Gjoni**

**KRYETARE**

**FLORJANA KOKA**

**Adresa:Rruga "Abedin Dino"** **Tel.&Fax.085 222380** **Email:bashkiasarande@yahoo.com**

Scanned with CamScanner

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË
DREJTORIA JURIDIKE

# KONTRATË

Sot më date 30.06.2016 në bazë të nenit 419-658 dhe 850 -876 të Kodit Civil,te Ligjit Nr. 139/2015 "Per Veteqeverisjen Vendore, Midis palëve Bashkia Sarandë (Autoriteti kontraktor ) përfaqësuar nga Kryetari i saj **Znj.**Florjana KOKA dhe **shoqerise "HP STUDIO" me administrator Z.Ilirjan PROKO** (më poshtë mbikqyrës punimesh) me license **MK.** 2529/1 datë 07.04.2015 lidhet kjo kontratë. Palët e mësiperme bien dakort për sa me poshte:

## Neni 1 Objekti i Kontrates

**Mbikqyrja e objektit:** "Rikonceptim dhe rivitalizim I qendres se qytetit Sarande, Rruga e Flamurit".

1.1. Kjo Kontratë lidhet në baze te vendimit te Kryetarit te Bashkisë **Nr.** 6/1 datë **30.06.2016** "Per caktimin e mbikqyresit të punimeve"

## Neni 2 Vlefta e Kontratës

Vlefta e kontratës është: **100 000** ***(njeqind mijë)*** lekë te llogaritur nga organi që ka vënë në dispozicion fondin, te ardhurat e Bashkise Sarande.

## Neni 3 Detyrimet e mbikqyrësit të punimeve (Supervizorit)

3.1. Për cdo objekt që ndërtohet ,mbikqyrësi i punimeve mban dhe përgjigjet per dokumentacionin e mëposhtem:

- Vendimin e K.RR.T –së për sheshin ose lejen e ndertimit dhe lejen orgjinale të ndërtimit.



HP STUDIO

Scanned with CamScanner

- Projektzbatimin e firmosur nga projektuesi nga bashkia ose nga këshilli i qarkut sipas juridiksionit
- Dokumentacioni topografik dhe gjeologo - inxhinjerik i themeleve, bazamenteve dhe i punimevete maskuara.
- Dokumentacionin perkates i te gjitha ndryshimeve te mundshme qe mund te jene bere ne projekt gjate ndertimit te objektit pa pekur kushtet e vena ne vednimin e K.RR.T-se.
- Plan organizimin e punimeve.
- Mbikqyresi i punimeve eshte i detyruar te kontrolloje periodikisht dhe ne fazat kryesore ,librin e kantierit ,dhe eshte pergjegjes per saktesine e vertetesine e dokumenteve qe pasqyrohen ne te.

3.2. Ne castin e fillimit te punimeve mbikqyresi duhet te beje verifikimet perkatese si me poshte:

- Verifikimi i dokumentacionit perkates si lejeve dhe autorizimeve sipas dispozitave ne fuqi,te cilat duhet te meren para fillimit te punimeve.
- Verifikimi i sheshit te ndertimit nese eshte i lire dhe i gatshem per te filluar punimet.
- Njohjen me hollesite e kontrates se sipermaries dhe e te gjitha akteve administrative qe lidhen me te , si dhe njohjen e te gjitha ndryshimeve te mundshme te kesaje kontrate me kalimin e kohes.
- Vendosjen e tabeles se identifikimit me te dhenat e meposhteme:
  a) emertimi i objektit
  b) data e marjes se lejes se ndertimit
  c) ivestitori
  d) projektuesi
  e) sipermaresi dhe drejtuesi teknik
  f) mbikqyresi
  g) afati i ndertimit
  h) siperfaqia e ndertimit
  i) lartesia (numri i kateve mbi dhe nen toke)
  j) Intensiteti sizmik i shehsit te ndertimit ,ne baze te studimit sizmiologjik dhe mikrozonimit sizmik.
  k) Per objete mbi 8 kate te dhenat estudimrvr inxchinjero-sizmike ,te mara nga institute i sizmiologjise
  l) Mbykqiresi I punimeve duhet te verifikoje materialet qe do te perdoren ne kantier me qellim qe ote te perputhen me kerkesat teknike te projektit.Materialet e ardhura si dhe paisjet esiguruara nga siperpmaresi qe nuk do te pranohen nga mbykqyresi do te zevendesohen me te tjera, me shpenzimet e sipermaresit.

Adresa : Rruga "Abedin Dino", Tel & Fax 085 22 2380 E-mail: bashkiasaranda@yahoo.com

SHERBIME NE PROJEKTIM IP STUDIO ALBANIA NUIS: L32229030G

Scanned with CamScanner

m) Per gjithe problemet e verifikuara prej tije ,mbikqyresi I punimeve duhet te firmose gjithca ka miratuar.Ai mban pergjegjesi ligjore se bashku me sipermaresin.

## Neni 4 Dokumentacioni i hartuar nga mbikqyresi.

4.1. Mbikqyresi i punimeve ,pas verifikimeve te percaktuara me siper harton dokumentacionin e meposhtem:

a) aktin e dorezimit te sheshit te ndertimit shoqerise sipermarese
b) aktin e dorezimit nga sipermaresi te dokumentacionit teknik dhe administrative.
c) shkresen me ane te se ciles njofton pushtetin vendor per fillimin e punimeve.

## Neni 5 Te drejtat e mbikqyresit te punimeve

5.1. Mbikeqyresi punimeve ,gjate zbatimit te projektit i jep instruksione dhe urdhera me shkrim sipermaresit sa here qe e sheh te nevojshme, ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore,dhe ky i fundit eshte i detyruar ,ti respektoje ato ,por duke ruajtur te drejten e verejtjeve me shkrim tek investitori per keto urdhera.

5.2. Mbykqyresi i pnimeve ka te drejte te propozoje largimin nga puna te nje ose te disa personave nga personeli i sipermaresit.

5.3. Mbikeqyresi i punimeve ka te drejte te kerkoje kryerjen e provave te materialeve te ndryshme kur ato nuk jane kryer ne masn ,sipas vellimeve te realizuara dhe pjeses se lendes se pare te funizuar ,per te verifikuar cilesine.

5.4. Kur mbikqyresi i punimeve mendon se ka defekte ne zbatimin e punimeve, kerkon verifikimet perkatese.

5.5. Mbikeqyresi i punimeve ka te drejte te pezulloje perkohesisht punimet per zbatimin teknikte gabuar por gjithmone ,me miratim te investitorit, per aq kohe sa duhet per korigjimin e gjendjes.

5.6. Mbikeqyresi i punimeve kontrollon zbatimin e grafikut te punimeve dhe i raporton cdo muaj investitorit per ecurine e tije.Asnje punim mbulohet maskohet a betonoht pa miratimin e mbikeqyresit.

5.7. Mbikeqyresi i punimeve kontrollon perdorimin e fondit reserve te preventivuar ,dhe i raporton periodikisht investitorit.

## Neni 6.Te drejtat e investitorit.

6.1. Investitori ose dikasteri nga varet ky investitor ,kur veren shkelje te renda te dispozitave ligjore ose kushteve te kontrates se hartuar dhe te firmosur nga siprmaresi i punimve te ndertimit ka te drejte te urderoje mbykeqiresin e



IP STUDIO ALBANIA NUIS: L3222[illegible]30G

Scanned with CamScanner

punimeve te nderprese punen deri ne marjen e masave perkatese,per normalizimin e gjendjes.

6.2. Investitori mund te kerkoje largimin dhe zevendesimin e mbykqiresit kur vertetohen mangesi serioze si:

a) Mangesi ne plotesimin e detyrave te percaktuara ne kontrate.
b) Nderprerje e paarsyshm e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre.
c) Mangesi kontrolli ne kosto e kontabilitet ,tolerim i materialeve me vlera mbi ato te preventivuara ose jo me cilesi.

**Neni 7 Dokumentacioni teknik**

7.1. E gjithe korrespodenca e mbikeqyresit te punimeve me investitorin dhe me sipermaresin perben dokumentacionin e objektit dhe si i tille ruhet me cdo kusht.

7.2. Mbikeqyresi i punimeve mban dosien e mbikqyresit te punimeve, ku pasqyrohen te gjitha aktet e mbajtua gjate zbatimit te objektit, qe nga momenti i fillimit, procesverbale te ndryshme ,verejtje nderprerje punimeshe dhe shkaqet perse kane ndodhur ,relacionet teknike te kerkuara ose te paraqitura gjate zbatimit te punimeve.

7.3. Mbikeqyresi i punimeve mer pjese ne kolaudimin e vepres dhe i pergjigjet kolaudatorit me te gjithe dokumentacionin e nevojshem per kolaudimin e vepres, si dhe firmos procesverbalin e ketije kolaudimi.

**Neni 8 Menyra e pageses**

8.1. Pagesa nga ana e "Investitorit" do ti behet "Mbikeqyresit te punimeve" me urdher xhirimi ne llogarine rjedhese te tije.

**Neni 9 Afatet e pageses**

8.1. Pagesa do ti behet me nje kest ,pas marrjes ne dorezim te objektit nga ana e investitorit.

**Neni 10 Mosmarrveshjet**

10.1. Cdo mosmarveshje ndermjet palever te mesiperme duhet te zgjidhet me mirekuptrim midis tyre.Ne rast se ndodh kundershtim sejcili nga palet duhet te njoftojne palen tjeter me shkrim per shkakun e kundershtimit duke caktuar nje mbledhje nga te dy palet per te aritur ne zgjidhjen e kundershtimit.

10.2. Per cdo mosmarveshje qe nuk zgjidhet midis paleve ,ato mund ti drejtohen gjykates se rrethit Sarande.



SHERBIM KONSULENCE HP STUDIO ALBANIA NUIS: L32229

Scanned with CamScanner

10.3. "Investitori" mund te kerkoje largimin dhe zevendesimin e mbikqyrest kur vertetohen mangesi serioze ne veprimtarine e tije si me poshte:

a) Mangesi ne plotesimin e detyrave te percaktuara ne piken 1 te udhezimit nr.3 date 15.02.2001 te K.M.

b) Nderprje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatja e theksuar e tyre.

**Neni 11 Prishja e kontrates**

11.1. "Investitori " ose "Sipermarresi" mund te prishin kontraten n.q.se njera pale ben shkelje themelore te saj, gje qe privon plotesisht palen tjeter nga fitimet kryesore te kontrates.

*Konc.dakt. E. Gjoni*

**AUTORITETI KONTRAKTOR**

**BASHKIA SARANDË**

**KRYETARE**

**FLORJANA KOKA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA SARANDË -

**MBIKQYRËSI I PUNIMEVE**

**"HP-STUDIO"SH.P.K**

**ADMINISTRATORI**

**ILIRIAN PROKO**

SHERBIME KONSULENCE & ... HP STUDIO ALBANIA NUIS: L32229030G



Scanned with CamScanner

# PROCES-VERBAL

## Mbi akt piketimin ne objektin

**"Rikonceptimi dhe rivitalizimi i qendres se qytetit Sarande, Rruga e Flamurit"**

I mbajtur sot, me date: **20.10. 2016**, mbi aktin e piketimit ne objektin :

**"Rikonceptimi dhe rivitalizimi i qendres se qytetit Sarande, Rruga e Flamurit"**

Ndodheshin prezent:

1. Mbikqyresi i Punimeve, Shoqeria Konsulente:
   **" HP Studio"**, perfaqesuar nga **ing Ilirjan PROKO**

2. Sipermarresi i PunimeveShoqeria: **"ED KONSTRUKSION & FUSHA" sh.p.k ,** perfaqesuar nga DrejtuesiTeknik Ing. **Vullnet SEJDINI**.

Pas verifikimit ne vend u konstatua se objekti eshte i piketuar sipas projektit te miratuar.

Lejohet vazhdimi i punimeve sipas grafikut dhe projektit.

Procesverbali mbahet ne 4 (kater) kopje.

Nje kopje per investitorin: BASHKIA SARANDE

Nje kopje per Mbikqyresin e punimeve: Shoqeria "HP Studio"

Nje kopje per Sipermarresin e punimeve: **"ED KONSTRUKSION& FUSHA" sh.p.k**

**SIPERMARRESI I PUNIMEVE**
**"ED KONSTRUKSION" sh.p.k**
**DREJTUESI TEKNIK**
**Ing. Vullnet SEJDINI**

**MBIKQYRESI I PUNIMEVE**
**"HP Studio"**
**DREJTUESI TEKNIK**
**Ing Ilirjan PROKO**

Scanned with CamScanner

Nr.ShkollaHoxhatasim 1.p Nr prot Rikonceptimi dhe rivitalizimi i qendres se qytetit Sarande Tirane 20.10.2016

Lenda: **Njoftim per fillimin e punimeve ne objektin:**

**" Rikonceptimi dhe rivitalizimi i qendres se qytetit Sarande, Rruga e Flamurit"**

**BASHKISE SARANDE**

**Firmes Projektuese:**

Per dijeni : **"ED KONSTRUKSION" sh.p.k**

Te nderuar Zoterinj,

Shoqeria **"HP STUDIO"**shpk, eshte mbikqyrese e caktuar nga **Bashkia Sarande** per Objektin **"Rikonceptimi dhe rivitalizimi i qendres se qytetit Sarande, Rruga e Flamurit"**

Ju njoftojme se kompania **"ED KONSTRUKSION" sh.p.k** ka filluar punimet ne objektin: **"Rikonceptimi dhe rivitalizimi i qendres se qytetit Sarande, Rruga e Flamurit"** ne baze te kontrates , nr. 6 prot date **30.06.2016** lidhur me investitorin **Bashkia Sarande.**

***Objekti:*** **"Rikonceptimi dhe rivitalizimi i qendres se qytetit Sarande, Rruga e Flamurit"**

| | |
|---|---|
| ***Vlera e objektit:*** | **102 518 468 leke me T.V.SH** |
| ***Investitori:*** | **BASHKIA SARANDE** |
| ***Sipermarresi i punimeve:*** | **"ED KONSTRUKSION" &" FUSHA" sh.p.k** |
| ***Projektuesi:*** | **JV INFRA CONSULT PROJECT – 04 Sh.p.K & TEC.CONSULT Sh.p.K & ADRIAN TAFILI** |
| ***Mbikqyresi i punimeve:*** | **"HP Studio"** sh.p.k |
| ***Leja e sheshit te ndertimit:*** | ______________________ |
| ***Leja e ndertimit:*** | ______________________ |
| ***Data e fillimit te punimeve:*** | **20.10.2016** |
| ***Data e perfundimit te punimeve:*** | **/ /2017** |

Bashkengjitur po ju dergojme dokumentacionin perkates te ketij objekti.

**MBIKQYRESI**
**HP STUDIO**

**Ilirjan PROKO**



Scanned with CamScanner

# AKT DOREZIMI

# I SHESHIT TE NDERTIMIT

I mbajtur sot, me date **20/10/2016** mbi dorezimin e sheshit te ndertimit te objektit:

**"Rikonceptimi dhe rivitalizimi i qendres se qytetit Sarande, Rruga e Flamurit""**, prane bashkise Sarande , ne prezence te:

**Investitorit:**
**BASHKISE SARANDE** perfaqesuar nga **Ing.** Pëllumb Halimi.

**Mbikqyresi i punimeve:**
Shoqeria " HP Studio"

Inxhinier Rezident **Ing.Ilirjan PROKO**

**Sipermarresi i punimeve: Shoqeria "ED KONSTRUKSION &FUSHA" sh.p.k**

1.Drejtues Ligjor **Z.Alfred IBRAHIMI**

2.Drejtuesi Teknik Ing.Vullnet SEJDINI

3.Drejtuesi i kantierit Ing.Anila LEJMONI

Nga verifikimi ne vend iobjektit u konstatua se sheshi i ndertimit eshte i lire dhe se shoqeria sipermarrese **"ED Konstruksion & Fusha" sh.p.k**, merr ne dorezim kete shesh per realizimin e punimeve sipas kontrates se lidhur midis investitorit dhe kontraktorit me date **30/06/2016** per objektin:

**"Rikonceptimi dhe rivitalizimi i qendres se qytetit Sarande, Rruga e Flamurit"**

**Sheshi kufizohet:**

Nga Jugu Shetitorja Naim FRASHERI

Nga Veriu Parku Miqesia

Nga Lindja Rruga Skenderbeu

Nga Perendim Sinagoga dhe Bashkia

Akt -Dorezimi mbahet ne tre kopje si me poshte vijon:

-Nje kopje per investitorin: BASHKIA SARANDE

-Nje kopje per mbikqyresin e punimeve, shoqeria**"HP Studio"**
-Nje kopje per sipermarresin, shoqeria **"ED KONSTRUKSION & FUSHA" sh.p.k.**

**MBIKQYRESI I PUNIMEVE**
**"HP Studio"**
**Ing. Ilirian PROKO**

**SIPERMARRESI I PUNIMEVE**
**"ED KONSTRUKSION" sh.p.k.**
**ADMINISTRATOR**
**Z. Alfred IBRAHIMI**

**INVESTITORI**
**BASHKIA SARANDE**
Ing. Pëllumb Halimi

Scanned with CamScanner

**PROCES-VERBAL**
**Mbi fillimin e punimeve ne objektin**

**"Rikonceptimi dhe rivitalizimi i qendres se qytetit Sarande, Rruga e Flamurit"**

I mbajtur sot, me date **20.10.2016** mbi fillimin e punimeve ne objektin:

**"Rikonceptimi dhe rivitalizimi i qendres se qytetit Sarande, Rruga e Flamurit"**

Ndodheshin prezent:

1. **Mbikqyresi i Punimeve Shoqeria:** "HP Studio",
perfaqesuar nga Ing.Ilirjan PROKO.

**Sipermarresi i Punimeve Shoqeria: "ED KONSTRUKSION& FUSHA" sh.p.k,**
perfaqesuar nga Drejtuesi Teknik Ing. **Vullnet SEJDINI**

Shoqeria **"ED KONSTRUKSION & FUSHA" sh.p.k,** depozitoi prane mbikqyresit te punimeve nje kopje te kontrates, preventivin, grafikun e punimeve, listen e makinerive dhe te stafit.

Sipermarresi ka caktuar ne objekt:
**Stafin e perbere nga:**

| | |
|---|---|
| Drejtuesi Teknik | - Ing. Vullnet SEJDINI |
| Drejtues Punimesh | – Ing. Anila LEJMONI |
| Topograf | - Ing. Pandeli BERBERI |

**Makinerite**

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1. Eskavatore | cope 3 | 6. Greider | cope 1 |
| 2. Minieskavator | cope 1 | 7. Autobetonier | cope 1 |
| 3. Kamioncine | cope 1 | 8. Autobot uji | cope 3 |
| 4. Kamiona | cope 7 | 9. Autopompe | cope 1 |
| 5. Rrul | cope 3 | 10. Skela suvatimi | $m^2$ 1100 |

Data e fillimit te punimeve eshte **20.10.2016**.

Sipermarresi **"ED KONSTRUKSION & FUSHA" sh.p.k,** sh.p.k, te hape Ditarin e Objektit, te hartoje Librezen e Masave dhe te mbaje proces-verbalet perkatese me realizimin e proceseve te punes.

Fillimi i punimeve te nise nga piketimi i objektit. Te percaktohen dhe te shenohen ne terren piketat sipas projektit dhe pasi te kontrollohen dhe te aprovohen nga mbikqyresi i punimeve dhe inxhinieri gjeodet. Te hartohet proces-verbali perkates, ku te jene te pasqyruara matjet faktike dhe ne rast se nuk ka ndryshime nga projekti, te vazhdohet

Scanned with CamScanner

me punimet e tjera sipas grafikut te punimeve. Te vendoset tabela e objektit sipas formatit te miratuar. Te lajmerohen organet e qeverisjes vendore per fillimin e punimeve. Te lajmerohet Drejtoria e Tatim Taksave bashkia Sarande.

Proces-Verbali mbahet ne 4(kater) kopje, si me poshte vijon:

Per Investitorin: Bashkia Sarande
Per Mbikqyresin e punimeve: Shoqeria "HP Studio"
Per Sipermarresin e punimeve: "ED KONSTRUKSION &FUSHA" sh.p.k,
Per organet e qeverisjes vendore. Bashkia Sarande

| | |
|---|---|
| **MBIKQYRESI I PUNIMEVE**<br>**"HP Studio"**<br>**Ing.Ilirjan PROKO** | **SIPERMARRESI I PUNIMEVE**<br>**"ED KONSTRUKSION" sh.p.k,**<br>**Ing. Vullnet SEJDINI** |

**INVESTITORI**
**BASHKIA SARANDE**
**PERFAQESUESI**
Ing. Pëllumb Halimi

Scanned with CamScanner

# DITARI I OBJEKTIT

**OBJEKTI:"Rikonceptimi dhe rivitalizimi i qendres se qytetit Sarande.Rruga e Flamurit"**
**Kontraktuesi. "Ed-Konstruksion & Fusha Sh.p.k. "**

**INVESTITORI: " BASHKIA SARANDE "** **Data 20/10/2016**

| MOTI | | | TEMPERATURA | |
|---|---|---|---|---|
| E mire | Me shi | Me debore | Min | Max |
| | | | | |
| + | | | | |

**Punojnë në Objekt;**
**Personeli Drejtues.**

1.Ing.Ndërtimi 2
2.Teknik Ndërtimi 1

**Specialistë dhe punetorë**

1.Specialistë 7
2.Punetorë 15
3.Manovratore 4

**Makineri dhe pajisje ne objekt per kryerjen e te gjithe punimeve .**

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Kamion/Kamioncine | 2 | 7 | Sharre | |
| 2 | Eskavator/Minieskavator | | 8 | Gjenerator | 1 |
| 3 | Makineri Freze | | 9 | Cekic Pneumatik | |
| 4 | Rrul | | 10 | Autobetoniere/ Autopompe | |
| 5 | Autovinc | 2 | 11 | Makineri per mbjellje bari | |
| 6 | Autobot | | 12 | Skela metalike | |

**U kryen keto procese pune**

Punime pergatitore. U sollen materiale per rrethimin e objektit dhe filloi rrethimi I objektit.

**U mbajt dokumentacioni teknik;**
**1.Proces Verbale**
**2.Skica dhe vizatime**
**3.Ditar punimesh** ✓
**4.Librezë masash**

**Shenime te mbikqyresit**

Sipermarresi
"Ed-Konstruksion & Fusha" Sh.p.k
Drejtuesi I kantierit:
Ing. Valmet Sejdini

ED-KONSTRUKSION SH.P.K
Tiranë - Albania

Mbikqyresi i punimeve
"HP STUDIO" sh.p.k.
Ing.Ilirjan PROKO

Scanned with CamScanner

# PROCES – VERBAL

## ( Mbi Perfundimin e Punimeve )

**OBJEKTI: "RIKONCEPTIMI DHE RIVITALIZIMI I QENDRËS SË QYTETIT SARANDË, RRUGA E FLAMURIT"**

**Ne Baze te Udhezimit te Keshillit te Ministrave NR3 DATE 12.02.2011 i ndryshuar 'Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit Kreu 1 dhe 15 dhe udhezimit te Keshillit te Ministrave Nr 2 Date 13.05.2005 per zbatimin e punimeve te ndertimit Kreu II pika 10 mbahet ky process verbal per vertetimin e dates se punimeve per sa vijon me poshte**

Sot me date 20/05/2017 midis

1.Mbikqyresit te punimeve **"HP STUDIO" sh.p.k ,** Ing. Ilirjan Proko dhe Zbatuesit te Punimeve "Ed-Konstruksion" sh.p.k me Drejtues Teknik Ing. Vullnet Sejdini dhe Administrator Alfred Ibrahimi

Sipermarresi i Punimeve me shkresen date 20/05/2017 ka njoftuar

Mbikqyresin e punimeve **"HP STUDIO" sh.p.k** dhe Investitorin **Bashkia SARANDE** per perfundimin e punimeve sipas projektit dhe preventivit.

2. Mbikqyresi i Punimeve me date 20/05/2017 ne prezence dhe te perfaqesueseve te firmes "ED-KONSTRUKSION" sh.p.k me Drejtues Teknik Ing. Vullnet SEJDINI dhe Administrator Alfred IBRAHIMI kontrolloi punimet e kryera dhe konstatoi punimet ne objekt jane kryer konform projektit dhe preventivit te miratuar nga investitori.

Mbikqyresi I Punimeve pas kontrollit arrin ne perfundimin se kerkesa e Sipermarresit eshte e drejte dhe objekti: "Rikonceptimi dhe rivitalizimi i qendrës së qytetit Sarandë, Rruga e Flamurit" eshte perfunduar.

3. Data Perfundimit te punimeve eshte me 20/05/2017

Mbeshtetur ne keto te dhena objekti eshte gati per tu kolauduar dhe per tu marre ne dorezim nga organet perkatese.

| Mbikqyeresi i Punimeve | Spermarresi i Punimeve |
|---|---|
| "HP STUDIO" sh.p.k<br>Ing. Ilirjan Proko | "Ed-Konstruksion" sh.p.k<br>Administratori<br>Alfred IBRAHIMI<br>Drejtuesi Teknik<br>Ing. Vullnet Sejdini |

Scanned with CamScanner

# RAPORT PERFUNDIMTAR

**OBJEKTI : Rikonceptimi dhe rivitalizimi i qendrës së qytetit Sarandë, rruga e Flamurit**

I mbajtur sot me date . .2017, ne objektin **"Rikonceptimi dhe rivitalizimi i qendrës së qytetit Sarandë, rruga e Flamurit, ne Institucionin e Bashkise Sarandë"**, nga: Mbikqyresi i punimeve: **"HP STUDIO"**, per punen e kryer ne kete objekt per periudhen **20.10.2016** deri ne daten **20.05.2017**.

